



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UJËSJELLËS KANALIZIME KAMËZ SH.A

Nr. _____ Prot.

Kamëz, më ____/____/ 2026

RELACION TEKNIK

PER OBJEKTIN :

“BLERJE MATERIALE PËR UJËSJELLËS DHE KUZ + MATERIALE ELEKTRIKE”

Ujësjetllës Kanalizime Kamëz sh.a:

MIRATOHET

ADMINISTRATOR

SHPETIM LESKAJ

RELACIONI TEKNIK

Shoqëria **Ujësjiellës-Kanalizime Kamëz sh.a**, në kuadër të realizimit të nevojave të saj operative dhe me fondet e vëna në dispozicion për vitin 2026, do të zhvillojë procedurën me objekt:

“Blerje materiale për Ujësjiellës dhe KUZ + materiale elektrike”.

Të përgjithshme

Relacioni teknik i mëposhtëm hartohet për objektin: **“Blerje materiale për Ujësjiellës dhe KUZ + materiale elektrike”.**

Kjo procedurë prokurimi realizohet për të përmbushur nevojat e përditshme të shoqërisë Ujësjiellës-Kanalizime Kamëz sh.a., në funksion të mirëmbajtjes, riparimit dhe përmirësimit të rrjetit të ujësjiellësit, kanalizimeve dhe sistemeve elektrike.

Qëllimi i përgatitjes së kërkesave teknike është sigurimi i materialeve cilësore, bashkëkohore dhe në përputhje me standardet teknike në fuqi, duke garantuar përdorim të sigurt, efikas dhe afatgjatë për nevojat e ndërmarrjes.

Përshkrimi i objektit të prokurimit me qëllim njohjen e tij

Ky objekt prokurimi përfshin furnizimin me materiale hidraulike, materiale për kanalizime si dhe materiale elektrike, të nevojshme për përballimin e problematikave dhe ndërhyrjeve që paraqiten në territorin e Bashkisë Kamëz gjatë vitit 2026.

Nevojat për këto materiale janë evidentuar nga strukturat teknike dhe njësitë administrative të shoqërisë siç janë: **Kamëz, Bathore, Laknas-Valias, Paskuqan, Babrru**, për shkak të amortizimit të rrjetit ekzistues, shtimit të ndërhyrjeve në terren dhe mirëmbajtjes së vazhdueshme të sistemeve.

Ky furnizim synon:

- Përmirësimin e shërbimit të furnizimit me ujë për abonentët;
- Kryerjen në kohë të riparimeve dhe eliminimin e defekteve në rrjet;

- Përmirësimin e sistemit të kanalizimeve dhe shmangien e problematikave mjedisore;
- Garantimin e funksionimit normal të depove, stacioneve dhe sistemeve elektrike;
- Rritjen e eficiencës së mirëmbajtjes së rrjetit të ujësjellësit dhe kanalizimeve.

Kriteret e Cilësisë dhe Sigurisë

Materialet që do të furnizohen duhet të jenë:

- Të reja, të papërdorura dhe pa defekte;
- Të certifikuar sipas standardeve shqiptare dhe europiane;
- Rezistente ndaj lagështirës, konsumit dhe kushteve të mjedisit;
- Të përshtatshme për përdorim në sistemet e ujësjellësit, kanalizimeve dhe instalimeve elektrike;
- Të pajisura me dokumentacion teknik dhe certifikata cilësie nga prodhuesi.

Operatori ekonomik duhet të garantojë cilësinë dhe origjinën e materialeve të furnizuara.

Afatet dhe Dorëzimi

Furnizimi i materialeve do të realizohet sipas nevojave të Autoritetit Kontraktor dhe brenda afateve të përcaktuara në kontratë ose në minikontrata.

Dorëzimi i mallrave do të bëhet në magazinat e Shoqërisë Ujësjellës-Kanalizime Kamëz sh.a., i shoqëruar me dokumentacionin përkatës si:

- Faturë tatimore;
- Certifikatë cilësie;
- Deklaratë konformiteti;
- Garanci sipas specifikimeve teknike.

Përfundime dhe Konkluzione

Realizimi i kësaj procedure është i domosdoshëm për garantimin e vazhdimësisë së shërbimit dhe përmirësimin e infrastrukturës së ujësjellës-kanalizimeve në territorin e Bashkisë Kamëz.

Nëpërmjet këtij furnizimi synohet rritja e cilësisë së shërbimeve, reagimi më i shpejtë ndaj problematikave në terren dhe mirëmbajtja efikase e sistemeve hidraulike dhe elektrike.

Fondi Limit

Argumentimi i fondit limit është bërë bazuar në analizën e tregut, nevojat reale të ndërmarrjes dhe preventivin paraprak të materialeve që do të prokurohen, i cili është 32,000,000 (tridhjetë e dy million) lekë pa TVSH.

Në të gjitha rastet kur përmenden marka, emër tregtar, origjinë specifike ose prodhues, do të pranohet edhe ekuivalenti i tyre, në përputhje me legjislacionin për prokurimin publik.

Grupi i punës:

- Eglantina Disha Ing.Mjedisi
- Sajmir Bushkolaj Supervizor
- Mirgeta Koka Ekonomiste